

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-36691
Më 8.4.2014

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur, më 8.4.2014, me drejtorinë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për procedimin e Draftstatutit të Teatrit Profesional të Qytetit, dhe mori këtë

K O N K L U Z I O N

Miratohet Draftstatuti i Teatrit Profesional të Qytetit, i propozuar nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, me plotësimet dhe rekomandimet e bëra.

I propozohet Komitetit për Politikë dhe Financa që ta shqyrtojë Draftstatutin e lartcekur dhe, pas shqyrtimit, atë t'ia propozojë Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Obligohet Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, që, pas marrjes së këtij konkluzioni, të procedojë me lëndën në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe në Kuvendin e Komunës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdeset: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe komisioni që ka hartuar draftstatutin.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, komisioni që ka hartuar draftstatutin, KPF-ja, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna e Prizrenit

Kryetari i Komunës

Nr. 01/011-39092

Më 8.4.2014

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për lejimin e mjeteve për përkrahje financiare për disa aktivitete sportive, kryetari i Komunës, më 8 prill 2014, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për lejimin e mjeteve për përkrahje financiare për disa aktivitete sportive - turne.

Aktivitetet sportive (turnet) që përkrahen financiarisht janë:

1. Turneu tradicional përkujtimor i futbollit kushtuar dëshmorit Sinan Thaqi, që mbahet në Prill në fshatin Zojz, përkrahet financiarisht me 500 €.
2. Turneu tradicional i shahut "Faleminderit Kukës 2013" që organizohet në muajin maj 2014 në Prizren, përkrahet financiarisht me 500 €. Ky turne organizohet në bashkëpunim me revistën "Fidani";
3. Turneu tradicional përkujtimor në futboll kushtuar dëshmorit Përparim Thaqi, që mbahet në prill në fshatin Landovicë, përkrahet financiarisht me 300 €.
4. Turneu i futbollit kushtuar "Rinisë së Prizrenit", që mbahet në prill 2014, në Prizren, përkrahet financiarisht me 300 €.
5. Turneu i futbollit për veteran që mbahet në maj 2014 dhe që organizohet nga KO i këtij turne, përkrahet financiarisht me 300 €.
6. Turneu përkujtimor i futbollit "Pal Paluca", që mbahet në maj 2014, përkrahet financiarisht me 300 €.
7. Turneu i futbollit në Pllanjan, që mbahet në maj 2014 përkrahet financiarisht me 300 €.

Gjithsej shuma e përgjithshme e mjeteve që lejohen në emër të përkrahjes financiare për aktivitete e lartcekura është 2500 €.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve i Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja